ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **205-23-11085-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **Ndërtimi i rrugës Prizren - Kufiri me Maqedonin e Veriut (Tetovë), segmenti Struzhë - Kyçja në Auto-udhën dr.Ibrahim Rugova në Prizren - Jug, L=20.350 km,; Loti 1 - L= 6+913.73 km; Loti 2 = L= 6+525.00 km; Loti 3 = L= 6+911.27 km;**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË**
NUI	**810794463**
Adresa	**Rr. Tringe Smajli 16/7**
Vendi	**Prishtine**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Arben Sadrija**
Adresa elektronike	**pevlaku.ks@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**18.04.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Ndërtimi i rrugës Prizren - Kufiri me Maqedonin e Veriut (Tetovë), segmenti Struzhë - Kyçja në Auto-udhën dr.Ibrahim Rugova në Prizren - Jug, Loti 1 - L= 6+913.73 km;

Njoftimi për kontratë: 21.11.2023
Hapja e ofertave: 31.11.2023
Njoftimi mbi vendimin e AK: 03.02.2024
Kërkesa për qasje ne dokumente : 04.04.2024
Qasja e dokumente : 04.04.2024
Kërkesa për rishqyrtim: 08.04.2024
Njoftimi mbi Vendimin e AK:15.04.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Njoftimi për kontratë: 21.11.2023
Hapja e ofertave: 31.11.2023
Njoftimi mbi vendimin e AK: 03.02.2024
Kërkesa për qasje ne dokumente : 04.04.2024
Qasja e dokumente : 04.04.2024
Kërkesa për rishqyrtim: 08.04.2024
Njoftimi mbi Vendimin e AK:15.04.2024

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji Nr.04/L-042 i Prokurimit Publik te Republikës se Kosovës i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092

Neni 1 i LPP-së – Qëllimi

Neni 7 i LPP-së – Barazia ne trajtim /Jo diskriminim

Neni 27 i LPP-së – Dosja e tenderit

Neni 57 i LPP-së – Sigurimi i tenderit

Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Neni 60 i LPP-së – Kriteret e dhënies se kontratës

Neni 68 i LPP-së- Gjendja Ekonomike dhe Financiare e Operatorit

Neni 69 i LPP-së – Aftësia teknike dhe /ose profesionale

Neni 72 i LPP-së – Dokumentacioni dhe Informacioni shtese

Rregullat dhe udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik

2. Qëllimi i rregullave dhe udhëzuesi

26.Kriteret e përzgjedhjes

27. Grupi i Operatoreve Ekonomik

41.Ekzaminimmmi, Vesimi dhe Krahasimi i Tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne konzerciumi JV: "PE-VLA-KU" Sh.P.K – Dega në Kosovë dhe "JOOS & KRASNIQI- BAZE" SH.P.K, kemi marre pjesë në tenderin Ndërtimi i rrugës Prizren -Kufiri me Maqedonin e Veritu (Tetovë), segmenti Struzhë – Kyçja në Auto- udhën Dr.Ibrahim Rugova në Prizren – Jug, L= 20.350km; Loti 1= 6 913.73km; Loti 2= 6 525.00km; Loti 3 = 6 911.27km ; Loti 1 me çmimin 8,277,770.00 €

Me datën: 03.04.2024 përmes platformës elektronike E-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, ku e ka rekomanduar për kontratë grupin e **JV: "4 A-M Premium Beton SH.P.K GPG Company Sh.p.k ,** me çmimin **7,999,999.00€,** ndërsa neve na ka shpallur si tenderues të eliminuar. Po atë dite kemi bere kërkesën për qasje ne dokumente zyrtare mirëpo për arsyje te ndryshimeve qe kane ndodhur ne e-prokurimi nuk e kemi pare konfirmimin per ditën dhe orën e caktuar per qasje ne dokumente.

Ne konzerciumi Ankues me date 08.04.2024 (afati i fundit për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim pranë AK) kemi shkuar tek AK: Ministria e Infrastrukturës për te kërkuar realizimin e qasjes ne dokumente, mirëpo, përfaqësuesit e AK kane refuzuar kërkesën per qasje me arsyetimin se orari juaj ka qene i caktuar dhe ju nuk jeni paraqitur, qe nënkupton se afati për qasje ka skaduar.

Sipas Ligjit për Prokurimin Publik dhe Udhezuesit Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nuk është përcaktuar afat ligjor për realizimin e qasjes, por theksohet se qasja duhet te realizohet ne mënyre te menjëhershme dhe pa pengesa. Në këtë rast, AK duke i'a mohuar te drejten OE Ankues per qasje ne dokumente ka vepruar ne kundershtim me Nenin 10 te LPP. Kete pretendim e mbeshtet edhe

praktika e OSHP ku ne vendimin PSH. 255/18, eshte trajtuar rasti identik si ky i OE Ankues

Për me tepër, para skadimit te afatit për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim, secili OE ka te drejte te parashtroje dy apo me shume here kërkesë për qasje. Rrjedhimisht, ky pretendim duhet te vlerësohet si i bazuar.

Kërkesën për rishqyrtim e kemi bërë me datën: 08.04.2024, në të cilën kërkesë i kemi paraqitur të gjitha pretendimet tona dhe te cilën kërkesë AK: Ministrisë se Infrastrukturës e cila me datën 15.04.2024 ka dërguar Vendimin për refuzimin e kërkesës tonë si të pa bazuar me arsyetimet e njëjta si në Letrën Standarde për Eliminues

Në vazhdim do ti paraqesim pretendimet tona :

Sipas kërkesës së dosjes se tenderi përkatësisht Kërkesat mbi mundësin teknike dhe/ose profesionale, pika 9.1 &9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional, tek dëshmitë e kërkuar dokumentar është kërkuar CV-ja Diploma e noterizuar, referencat për punët e mëparshëm ne lëmin e kërkuar te lëshuar nga punëdhënësi, kontrate punës ose marrëveshje për bashkëpunim me punëdhënësin duke specifikuar titullin e projektit, për te cilin ka lidhe kontrate marrëveshje (kopje e kontratës e noterizuar).

Kompania jone është kompani që vepron në Shqipëri, Kosove, tani me edhe në Maqedoni dhe Kroaci. Stafi jonë është ndërkombëtarë dhe kryesisht stafi profesione është nga Shqipëria. Gjithashtu ky stafi është me përvojë mbi 10 (dhjete) vjeçare në kompani, ku letë dëshmohet edhe me lista të punëtoreve.

Preteksti i AK: Ministria së Infrastrukturës, që diploma nuk është e noterizuar nuk qëndron pasi qe sipas kërkesë së dosjes se tenderit ka qene e noterizuar diploma, kontrata dhe e gjitha dosja e Ing me një noterizim të përbashkët. Për secilin inxhinier veç e veç. Për arsyja që dokumentet inxhiniereve janë nga Shqiperia, behet vërtetim i kopjes nga origjinali ne Shqiperi, ndërsa duke u bazuar ne ligjin per noteri ne Kosove behët vërtetimi i dokumenti mbi atë te noterizar ne Shqiperi.

Gjithashtu ne dosje janë kërkuar kontrata te përfunduara ne lëmine e kërkuar per periudhën e shkuar tre vieçare nga data e publikimit te kontratës, jo me pak se :

Loti 1: 13,000,000.00 euro

Konzercium jone ka paraqitur listën e kontratave për pune te ngjashëm te cilat e mbërrij vlerën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktes per Loti1. Pretendimi i AK: Ministrisë së Infrastrukturës, per mospërmbushjen e kërkese pasi qe nje projekt qe e kemi paraqitur ne liste nuk i plotëson kriterin nuk qëndron, sepse për te njëjtin projekti nga i njëjti Autoriteti Kontraktue kemi marre procesverbalin dhe referencën per pune e realizuar deri ne atë vlere, dhe qe arsyja e vazhdimit te punimeve është ndryshimi i planit te ndërtimit te rrugës nga Autoritet Kontraktues. Bashkëlidhur e gjeni procesverbalin dhe referencën deri ne ate vlere.

Të gjitha këto konstatime dhe prova te bashkangjitura vërtetojnë se Autoriteti Kontraktues: Ministria e Infrastrukturës, ne rastin konkret ne mënyre flagrante ka bere shkelje esenciale te dispozitave te lartcekura te LPP-se.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura, shihet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm dhe njëkohësisht është favorizim i hapur kundrejt OE të rekomanduar për kontratë.

Autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

V E N D I M

APROVOHET, si e bazuar ankesa e JV: **PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË**

KOSOVË "JOOS&KRASNIQI-BAZE" Sh.P.K si dhe të

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM,**

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, përgatitjen e kërkesave për rishqyrtim, ankesave etj. në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*